

Landskrona stad

Liria e zgjedhjes së përkujdesjes në shtëpi



Çka është liria e zgjedhjes?

Liri e zgjedhjes së përkujdesjes në shtëpi do të thotë se, Ti që e ke të aprovuar të drejtën për ndihmë dhe mbështetje, vet e zgjedh ekzekutuesin i cili do t'ja jap ndihmën ty. Si ekzekutues konsiderohet forma komunale e përkujdesjes në shtëpi ose ndonjë sipërmarrje tjetër që është e pranuar nga bashkia/qyteti.

Kush të ndihmon të zgjedhësh?

Referenti në autoritetin e Administratës së Përkujdesjes, heton dhe merr vendim rreth ndihmës që mund të marrësh. Ata të informojn, si me shkrim ashtu edhe me gojë, se cilët ekzekutues veprojnë në zonën tënde të banimit. Referenti poashtu të ndihmon me plotësimin e aplikimit për ekzekutues.

Kjo ndihmë mund të ofrohet nga përkujdesja në shtëpi

- Ndihmë dhe mbështetje në formë të Shërbimit – fshirje, larje, blerje, hudhje mbeturinash.
- Ndihmë dhe mbështetje në formë të Kujdesit personal- lëvizje, larje në dush, të ushqyerit, kontakte sociale, shoqëruar, ndihmë shkarkuese.
- Ndihmë dhe mbështetje me ca intervenime shëndetsore-mjekësore siq janë; barëra, pika për sy, insulinë etj.

Kërkesat kualitative

Të gjithë ekzekutuesit e përkujdesjes në shtëpi duhet të punojnë në bazë të këtyre kushteve themelore për kualitet:

- Siguri
- Pjesëmarrje
- Ndikim

Liri e zgjedhjes së përkujdesjes në shtëpi

Çka mund të zgjedhësh?

- Ti mund të zgjedhësh ekzekutues, jo person të posaqëm, i cili është i pranuar në zonën t'uaj të banimit.
- Ti mund të zgjedhësh një ekzekutues për shërbime e një tjetër për kujdesje personale apo intervenime shëndetsore, ose një ekzekutues për të gjitha masat ndihmëse.

Nëse nuk zgjedh ekzekutuesin, pra jo-zgjedhje, Ty të jepet ndihma nga përkujdesja shtëpiake e qytetit.

Çka nuk mund të zgjedhësh?

Qyteti mban përgjegjësinë si më përpara për:

- Alarmi i sigurisë, 24 orë.
- Intervenime nate nga 22.00 deri 07.00
- Shpërndarjen e ushqimit
- Punësimin e personit kontaktues
- Ndhimë nga infermeria, fizioterapeuti, terapeuti i punës

Rizgjedhje

Nëse, Ti nuk je i kënaqur me një ekzekutues, mund të zgjedhësh një tjetër. Referenti në autoritetin e Administratës së Përkujdesjes të ndihmon për të bërë rizgjedhjen

Sa kushton përkujdesja në shtëpi?

Tarifa e përkujdesjes e cila bazohet në një tarifë maksimale, është e njëjtë pavarësisht ekzekutuesit dhe pagesa i bëhet qytetit të Landskronës

Blerja e shërbimeve shtesë

Disa ekzekutues privat, ofrojnë shërbime shtesë, si p.sh. punë kopshti apo larje dritaresh. Për këto shërbime paguhet ekstra, dhe Ti e paguan ekzekutuesin drejtëpërdrejt.



Ankesa dhe parashtresa

Nëse ke ankesa dhe parashtresa, në radhë të parë duhet t'i drejtohesh ekzekutuesit të ndihmës. Ju mund t'i drejtoheni edhe qytetit të Landskronës në telefonin: 0418-47 00 00.


Doni të dini më tepër?

Kontaktoje referentin tënd në Administratën e Përkujdesjes nëpërmes centralit telefonik të qytetit, telefoni: 0418-47 00 00.

Gjuhë tjera

Informacion rreth lirisë së zgjedhjes së përkujdesjes në shtëpi, ka në këto gjuhë: finlandisht, arabisht, shqip, boshnjakisht, kroatisht, serbisht dhe anglisht.

Adresa postale: Landskrona stad, Omsorgsförvaltningen, 261 80 Landskrona
Telefoni: 0418-47 00 00



Landskrona stad